



HAL
open science

Vështrim antropologjik mbi historinë, gjendjen aktuale dhe të ardhmen e studimeve shqiptare

Albert Doja

► To cite this version:

Albert Doja. Vështrim antropologjik mbi historinë, gjendjen aktuale dhe të ardhmen e studimeve shqiptare. Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, Akademia e Shkencave, Nov 2021, Tirana, Albania. Vol. III, 307-333, <https://youtu.be/5buwp-GBJ0M>. <halshs-03525750>

HAL Id: halshs-03525750

<https://shs.hal.science/halshs-03525750v1>

Submitted on 5 Aug 2024

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire HAL, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.



HAL Authorization

Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike

Vëllimi III

Përgatitën botimin:

Shaban Sinani
Pëllumb Xhufi

Aktet e Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike botohen
nën kujdesin e akad. **Skënder Gjinushi**, Kryetar i Akademisë së
Shkencave

Tiranë, 2024

Albert Doja

Profesor i antropologjisë në Universitetin e Lilës, Francë

Vështrim antropologjik mbi historinë, gjendjen aktuale dhe të ardhmen e studimeve shqiptare

Përmbledhje

Për një vështrim antropologjik mbi studimet shqiptare, në këtë shkrim, theksi vihet në një dallim të dyfishtë operacional. Nga njëra anë, karakteri shkencor i qasjeve dhe prurjeve të ndryshme disiplinore e ndërdisiplinore në fushat përkatëse që karakterizojnë studimet shqiptare gjatë zhvillimit dhe lëvrimit të tyre në periudha të ndryshme historike. Nga ana tjetër, paradigma shkencore që përbën kuadrin botëkuptimor e metodologjik, apo filozofinë e kërkimit shkencor, brenda së cilës janë zhvilluar e janë lëvruar këto apo ato qasje dhe prurje shkencore dhe jo të tjera sipas periudhave të caktuara historike. Qëllimi i këtij shkrimi është të tregojë nevojën dhe rëndësinë e nxjerrjes në pah të paradigmës albanologjike në studimet shqiptare gjatë tre dhjetëvjeçarëve të fundit në shek. XX-XXI, si dhe të parashikojë mundësitë e zhvillimit në të ardhmen.

Qasja antropologjike

Kjo kumtesë parashtron një meta-studim antropologjik mbi studimet shqiptare.¹ Antropologjia është një shkencë hipotetiko-deduktive që operon me ndërtim modelesh teorike dhe qasje krahasuese për të nxjerrë në pah dhe për të shpjeguar botëkuptimet që njerëzit krijojnë në përputhje me botën dhe mënyrën e jetesës së tyre. Për këtë qëllim, antropologët hulumtojnë produktet kulturore dhe dukuritë shoqërore që përbëjnë botën njerëzore dhe jetesën e popujve të ndryshëm, siç mund të jetë rasti, për shembull, me mitet dhe domethënien e tyre, si dhe rolin që ato luajnë si një produkt kulturor dhe dukuri shoqërore.

¹ Ky shkrim është një variant i zgjeruar i fjalës në Kuvendin Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, organizuar nga Akademia e Shkencave, 25-27 nëntor 2021. (Video link <https://youtu.be/5buwp-GBJ0M>).

Në këtë rast, nga pikëpamja metodologjike, kumtesa mbështetet në parimin e njohur antropologjik që Claude Lévi-Strauss e ka karakterizuar si një “vështrim prej së largu”¹, si dhe pikërisht në modelin e analizës strukturale që Lévi-Strauss ka përdorur për studimin e miteve², që është një model shpjegimor klasik në antropologji, ndonëse ende nuk njihet nga studiuesit e ciklit të kreshnikëve apo të epikës legjendare. Disiplinat historike, filologjike, folklorike, etnografike apo letrare, që merren me studimin e miteve dhe produkteve të ngjashme kulturore, synojnë të japin një përshkrim të hollësishëm e shterues të motiveve mitike dhe të huazimeve të mundshme për të përcaktuar origjinën e tyre, për të arritur te varianti burimor e më i hershëm, apo për të gjetur pikëtakimet midis motiveve mitike dhe të dhënave historike. Ndryshe, antropologjia synon të zbulojë qëllimin e aktorëve dhe mesazhin që komunikojnë mitet, për të shpjeguar përse njerëzit tregojnë këto apo ato mite dhe jo të tjera në një kohë, një vend, apo një situatë të caktuar. Qëllimi i aktorëve nuk është domosdoshmërisht i vetëdijshëm, ashtu si dhe domethënia e miteve nuk gjendet domosdoshmërisht në moralin, fabulën, motivet apo origjinën e mitit dhe lidhjet e drejtpërdrejta me realitetin historik. Domethënia e miteve nuk mund të zbulohet as me mikroskopin e të dhënave faktike, historike dhe filologjike, por me një “vështrim prej së largu” nëpërmjet analizës krahasuese të tërësisë së miteve dhe varianteve të tyre, që janë krijuar, rrëfihen dhe qarkullojnë në një shoqëri të caktuar apo janë huazuar nga shoqëri të tjera. Për këtë qëllim, antropologët marrin parasysh të gjitha variantet e mundshme, duke i trajtuar ato si një grup transformimesh, në kuptimin matematikor të fjalës, të cilat kryhen gjatë kalimit nga njëri variant në tjetrin.

Ndonëse studimi i miteve ka shërbyer në antropologji për të nxjerrë në pah dhe për të shpjeguar mënyrën se si është ndërtuar dhe si funksionon mendja njerëzore³, imagjinata shkencore për të

¹ Claude Lévi-Strauss, *Le regard éloigné* (Paris: Plon, 1983).

² Claude Lévi-Strauss, "The Structural Study of Myth," *Journal of American Folklore* 68, no. 270 (1955): 428–444, <https://doi.org/10.2307/536768>.

³ Claude Lévi-Strauss, *Le Cru et le Cuit*, vol. 1, Mythologiques (Paris: Plon, 1964); Claude Lévi-Strauss, *L'homme nu*, vol. 4, Mythologiques (Paris: Plon, 1971).

përdorur modele të tilla shpjegimore mundëson shqyrtimin në mënyrë kritike dhe krahasimore të çdo lloj produkti kulturor e dukurie shoqërore. Nëse studimet albanologjike i konsiderojmë thjesht si një produkt kulturor dhe dukuri shoqërore, atëherë me një imagjinatë të thjeshtë krahasuese, objekt i antropologjisë mund të jetë edhe praktika studimore albanologjike, që mund dhe duhet të studiohet si e tillë në kontekstin e vet historik e sociologjik.

Ashtu si në rastin e studimit të miteve, në këtë shkrim theksi nuk vihet mbi ndonjë zbulim me mikroskop të të dhënave faktike, për një përshkrim sado të hollësishëm e shterues të studimeve dhe të studiuesve të veçantë apo të tematikave dhe çështjeve të trajtuara, por mbi një analizë kritike krahasuese me një “vështrim prej së largu”, sipas parimit të njohur antropologjik, që në këtë rast mundëson një dallim të dyfishtë operacional dhe epistemologjik. Nga njëra anë, karakteri shkencor i qasjeve dhe prurjeve disiplinore në fushat përkatëse të studimeve shqiptare, si arkeologjia, filologjia, historia e gjuhës dhe e shkrimeve të vjetra e të trashëgimisë kulturore, historia politike dhe e formacioneve shoqërore, apo disiplina të tjera të përafërta, gjatë zhvillimit të tyre në periudha të ndryshme historike. Nga ana tjetër, paradigma albanologjike brenda së cilës janë zhvilluar e janë praktikuar këto apo ato qasje dhe prurje shkencore dhe jo të tjera sipas periudhave të caktuara historike.

Dallimi operacional dhe epistemologjik

Nga pikëpamja konvencionale, qasjet dhe prurjet shkencore disiplinore apo ndërdisiplinore mund t'i quajmë fare lirshëm ose “albanologji”, ose “studime shqiptare”, ose qasje ndërdisiplinore që përqendrohen në studimin e gjuhës shqipe dhe të historisë, të kulturës e të shoqërisë shqiptare, ose të gjitha së bashku, ose çfarëdo lloj emërtimi për të cilin biem kolektivisht dakord. Për qëllimet e këtij shkrimi, unë preferoj termin “studime shqiptare”, siç bëhet sot gjerësisht edhe gjetiu në raste të ngjashme për studimet rajonale. Në dallim nga qasjet dhe prurjet shkencore sipas disiplinave përkatëse, thjesht për arsye të diskriminimit semantik, termi “albanologji” mund të përdoret për të emërtuar paradigmen shkencore posaçërisht në fushën e studimeve shqiptare, duke dalluar respektivisht “studimet shqiptare” nga njëra anë dhe “paradigmen

albanologjike” nga ana tjetër. Nëse paradigma ideologjike në të cilën kanë lindur dhe vazhdojnë të praktikohen e të zhvillohen studimet shqiptare mund apo duhet cilësuar me termin “albanologji”, përsëri kjo çështje nuk përbën problem nga pikëpamja konvencionale, sepse mund të zgjedhim me konvencion çfarëdo lloj termi tjetër që mund të na duket më i përshtatshëm dhe për të cilin biem kolektivisht dakord.

Përsëri për qëllimet e këtij shkrimi, unë preferoj termin “albanologji” për t’iu referuar paradigmës shkencore të studimeve shqiptare, sepse ky term më duket më i përshtatshëm se terma të tjerë, thjesht për arsye historike. Ky term lindi dhe u konsolidua pa dyshim në shekujt XIX-XX, kur çështjet shqiptare erdhën e u bënë objekt kryesor i shqyrtimeve shkencore. Por pikërisht në këtë periudhë, termi “albanologji” ka mbartur në vetvete edhe një hipotekë të rënduar ideologjike të trashëguar nga tradita e studimeve shqiptare gjermanishtfolëse¹. Gjithashtu, le të kujtojmë se gjatë regjimit komunist përdorimi relativ i termit “albanologji” rezervohej për albanologët e huaj, por jo për albanologët shqiptarë. Kjo më bën të mendoj se në atë kohë duhet të ketë pasur një farë ndërgjegjësimit intuitiv kolektiv për t’u shkëputur nga ndikimi i ideologjive imperial-kolonialiste, që shpjegohet me imponimin e një kuadri të ri ideologjik nacional-komunist.

Dallimi midis studimeve shqiptare dhe paradigmës albanologjike është i rëndësishëm në radhë të parë nga pikëpamja epistemologjike. Sot pranohet gjerësisht se kriteri i vetëm për të dalluar qasjet dhe prurjet mirëfilli shkencore në çdo lloj studimi kërkimor është kriteri që sipas Karl Popper njihet si “falsifiabiliteti” apo përgënjeshtrimi i të dhënave të përdorura². Për ta thënë troç në shqip, kjo ka të bëjë me pritshmërinë që studiuesit ta vënë veten përpara të dhënave empirike të grumbulluara, sado të reja e të panjohura apo mahnitëse e interesante qofshin këto, dhe të bëjnë pyetjen përse gjërat janë kështu dhe jo ndryshe, si dhe pyetjen edhe

¹ Albert Doja, "The Beautiful Blue Danube and the Accursed Black Mountain Wreath: German and Austrian Kulturpolitik of Knowledge on Southeast Europe and Albania," *Soziale Welt: Zeitschrift für sozialwissenschaftliche Forschung und Praxis* 65, no. 3 (2014): 317-343, <https://doi.org/10.5771/0038-6073-2014-3-317>.

² Karl Popper, *The logic of scientific discovery* (New York: Basic Books, 1959; Repr., London/New York: Routledge, 1992).

më të thjeshtë «e çë pastaj?», e cila bëhet e tmerrshme nëse nuk ka me çfarë t'i përgjigjesh. E njëjta gjë ndodh edhe gjatë rrëfimit të miteve, legjendave, përrallave e meseleve, kur përtej përmbajtjes tematike të rrëfimit shpesh shtrohet pyetja përse rrëfohen këto apo ato mite apo cili është morali i fabulës së mitit në një situatë të caktuar. Por në fushën e studimeve shqiptare me sa duket askush nuk ia bën asnjëherë vetes këto lloje pyetjesh.

Nëse përpiqemi të kuptojmë me këtë mënyrë se çfarë qëndron për shembull prapa “kapriçove” të gjuhës, skutave të errëta të historisë apo dukurive të larmishme të kulturës, atëherë detyrimisht do na dalin përpara jo vetëm çështjet për t'u shpjeguar shkencërisht nga disiplinat kërkimore përkatëse, por edhe çështja nëse këto apo ato qasje nevojiten apo jo për studimet shqiptare. Në fund të fundit, ashtu si morali i fabulës kundrejt temës së rrëfimit, edhe motivimi prapa argumenteve shkencore, qofshin këto arkeologjike, filologjike, historike, kulturore apo shoqërore, shpesh është ndoshta më i rëndësishëm se vetë çështjet dhe argumentet shkencore.

Mënyra shkencore e arsytimit, apo “falsifiabiliteti” (përgënjeshtrimi) i të dhënave studimore, na bën të kuptojmë se studimet shqiptare dhe paradigma albanologjike janë dy kategori sociologjike të veçanta që nuk nënkuptojnë njëra-tjetrën. Ato janë gjëra krejt të ndryshme, që nuk duhet, madje nuk mund të ngatërrohen e të zëvendësojnë njëra-tjetrën, sepse ndryshimi i tyre është thelbësor, jo thjesht në nivelet e shkallëshkallshme të kësaj apo asaj veçorie, por në karakterin e qenësishëm dallues të tyre, shkencor apo ideologjik. Në vetvete, një ngatërrim i tillë mbetet një argument tautologjik i papranueshëm për arsye konceptuale dhe metodologjike, sikurse edhe ngatërrimi i shkencës me filozofinë e shkencës. Në këtë mes, duhet kuptuar, në radhë të parë, se nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë shkencë apo kërkim shkencor, as fushë disiplinore apo traditë studimore që prodhon këto apo ato dije dhe njohuri, pa u zhvilluar detyrimisht brenda një paradigme të caktuar shkencore, në një kuadër ideologjik, apo filozofi të kërkimit shkencor, siç quhet sot më gjerësisht, sepse dija dhe shkenca janë pjesë përbërëse të ideologjisë së një kohe të caktuar, në një shoqëri të caktuar dhe asgjë tjetër.

Kjo është çështje epistemologjike që, me siguri, nuk i ka shqetësuar asnjëherë albanologët, por nëse marrim parasysh një kuadër ideologjik e metodologjik gjithëpërfshirës, ku praktikohen e zhvillohen qasjet dhe prurjet shkencore të studimeve shqiptare, me këtë duhet kuptuar një sistem botëkuptimor, që njëherazi përcakton dhe përbëhet nga pikësynimet ideore, imagjinata shkencore dhe zgjedhjet metodologjike e teorike në fushën e studimeve shqiptare. Në këtë kuptim, raporti i paradigms albanologjike me studimet shqiptare është i barasvlershëm me raportin midis shkencës dhe filozofisë së shkencës, ashtu si skepticizmi, iluminizmi, racionalizmi, modernizmi, liberalizmi etj. nuk janë shkenca, por sisteme filozofike në kuadër të të cilave dhe sipas situatës është bërë i mundur kërkimi shkencor dhe zhvillimi i shkencave në çdo lloj fushe disiplinore.

Shpesh, ashtu si dhe në rastin e rrëfyesit të këtyre apo atyre miteve, studiuesit nuk janë domosdoshmërisht të vetëdijshëm për pikësynimet ideore dhe zgjedhjet e tyre teorike dhe metodologjike. Por ky dallim na lejon të kuptojmë se motivimet ideologjike dhe kushtet politike të trashëguara nga e kaluara, si për shembull, imperial-kolonializmi, nazifashizmi, apo nacional-komunizmi, kanë mundësuar formimin dhe zhvillimin e paradigms albanologjike si një kuadër filozofik në të cilin është zhvilluar kërkimi shkencor në studimet shqiptare sipas disiplinave përkatëse në periudha të ndryshme historike. Për krahasim, edhe antropologjia ka lindur dhe është zhvilluar në kuadrin ideologjik të imperial-kolonializmit, ashtu si një pjesë e mirë e saj është molepsur edhe sot nga ideologjitë e postmodernizmit. Sepse jo vetëm imperial-kolonializmi, orientalizmi, nacionalizmi, nazifashizmi, komunizmi, fundamentalizmi, por edhe postmodernizmi, nuk janë gjë tjetër veçse sisteme të caktuara ideore e botëkuptimore që shërbejnë si kuadër ideologjik përkatës për zhvillimin e traditave të caktuara dhe jo të tjerave, në kërkimet dhe studimet shkencore.

Gjatë komunizmit, përpunimi ideologjik i paradigms albanologjike drejtohej nga partia në pushtet dhe refleктоhej nga albanologët në studimet e tyre. Ndërsa në kushtet e sotme kulturore dhe ideologjike, prapa argumenteve shkencore, qofshin arkeologjike, filologjike, historike, kulturore apo shoqërore, motivime të caktuara strukturohen e rregullohen në mënyrë të

pavetëdijshme brenda një rrjeti marrëdhëniesh ndërmjet aktorëve të ndryshëm shoqërorë, të cilët shprehin apo vënë në lëvizje një agjenci të caktuar, që në kushte të caktuara dhe në një situatë të caktuar i shërben këtij apo atij qëllimi shoqëror, kulturor dhe ideologjik.

Ashtu si dhe në rastin e rrëfimit dhe qarkullimit të miteve, dashur padashur, çdo aktor, qoftë individ, grupim shoqëror apo institucion, përpiqet në mënyrë të pavetëdijshme të imponojë idenë e vet, me ku më shumë e ku më pak sukses, se si duhet të jenë dhe çfarë duhet të përfaqësojnë studimet shqiptare. Në këtë mënyrë, institucione të specializuara brenda apo jashtë Shqipërisë, studiues vendës apo të huaj, studiues zyrtarë apo të rrugës, studiues të përkrahur e të papërkrahur institucionalisht apo publikisht, përkrahës apo kundërshtarë të këtyre apo atyre teorive në veçanti, përkrahës apo kundërshtarë të studimeve shqiptare në përgjithësi, studimet e tyre të botuara e të pabotuara, për këto apo ato tematika, në botime prestigjioze apo margjinale, ashtu si dhe këto apo ato vlerësime të tyre brenda dhe jashtë vendit, në mjediset e ndryshme sociale dhe kulturore ku konsumohet dhe ku qarkullon kjo traditë kërkimore, në çdo rast shfaqin një variant apo një tjetër të paradigmës albanologjike në studimet shqiptare.

Të gjitha këto variante, në të cilat manifestohen studimet shqiptare, të marra së bashku si një grup transformimesh, bëjnë të mundur të rrokët morfodinamika e kuadrit botëkuptimor e metodologjik apo filozofia e kërkimit shkencor në studimet shqiptare. Nëse është kështu, atëherë debati duhet zhvendosur nga qasjet dhe prurjet shkencore tek elementet agjenciale që ato kërkohet të përcjellin në shërbim të kuadrit filozofik e metodologjik përkatës.

Studimi i çështjeve shqiptare dhe “ndikimet” ideologjike

Një punë e ngjashme është bërë me kohë dhe vazhdon të bëhet me shumë sukses në antropologji kundër trashëgimisë ideologjike të imperial-kolonializmit dhe, deri diku, edhe kundër molepsjes ideologjike prej postmodernizmit. Ndërsa shqetësime të ngjashme lidhur me paradigmën albanologjike, ashtu si e kemi trashëguar që nga shek. XIX, ende nuk janë shfaqur për të vlerësuar qasjet dhe

prurjet shkencore në fushën e studimeve shqiptare gjatë tridhjetë viteve të shek. XX-XXI.

Shpesh mëtohet se duhet luftuar për më shumë prurje të sakta e rezultate të prekshme prej albanologjisë, ndonëse me të drejtë mund të mburremi me arritjet shkencore pothuajse në të gjitha fushat kërkimore të studimeve shqiptare, ku ka shumë rezultate të kënaqshme dhe premtuese. Këtu nuk është vendi të ndalem për të shtjelluar vendin dhe rëndësinë e studimeve të tilla. Vetë punimet e Kuvendit të madh Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, organizuar nga Akademia e Shkencave, në 25-27 nëntor 2021, janë dëshmia më e mirë për këtë. Megjithatë, si këtu edhe me nisma të tjera të ngjashme, theksi vihet mbi planet e reja për studimet gjuhësore-letrare, mbi perspektivat dhe sfidat e studimeve historike, mbi piketat e kërkimeve arkeologjike, e kështu me radhë mbi arritjet, sfidat dhe akset kërkimore sipas ndarjes tematike apo institucionale të punës shkencore.

Ka edhe mendime se çështjet shqiptare të trashëguara pa ndryshim që nga shekulli XIV deri në shekullin XVII duhen reduktuar, ashtu si në shekullin XIX, vetëm te prejardhja, territori, gjuha, besimet, mënyra e jetesës dhe trashëgimia kulturore-historike e shqiptarëve, madje edhe vetëm te mbrojtja e tezës ilirike apo e tezës pellazge mbi etnogjenezën shqiptare.¹ Edhe pse njohuritë historike mund të jenë të mjaftueshme kryesisht vetëm për shekujt XIX-XX, duket qartë dhe nuk mund të thuhet se studimet shqiptare janë trajtuar nga një periudhë në tjetrën pa ndërprerje dhe pa ndryshime prej brezave të njëpasnjëshëm të albanologëve përmes shekujve. Gjatë shekujve XIV-XVI, interesi për çështjet shqiptare ka çuar domosdoshmërisht në regjistrimin e dokumentimeve të para. Gjatë shekujve XVII-XVIII, fillon interesimi ekzotik-sensacionalist për zbulimin e realiteteve shqiptare. Ndërsa gjatë shekujve XIX-XX, studimet shqiptare marrin hov prej përpjekjeve të vullnetshme me qëllime të caktuara imperial-kolonialiste dhe nacional-komuniste, apo vetëkolonizuese dhe vetizoluese. Këtyre u duhet shtuar periudha e tridhjetë viteve të fundit gjatë shekujve XX-XXI, kur

¹ Shih, për shembull: Bardhyl Demiraj, “Çështje Shqiptare”, *Peizazhe të Fjalës*, 07 shtator 2020, <https://peizazhe.com/2020/09/07/ceshtje-shqiptare/>.

studimet shqiptare ndodhen përpara zgjedhjeve që janë marrë apo duhet të merren për të zhvilluar studimet shqiptare në të ardhmen.

Pa dyshim, tipare të caktuara si karakteri ekzotik-sensacionalist apo imperial-kolonialist janë përcjellë nga një periudhë në tjetrën dhe ndoshta vazhdojnë edhe sot në forma të ndryshme neokoloniale apo vetëkolonizuese. Megjithatë, gjatë një procesi shoqëror që Thomas Kuhn e ka karakterizuar si revolucion shkencor¹, studimet shqiptare kanë përdorur metoda dhe teknika të caktuara të grumbullimit, regjistrimit, evidentimit, përshkrimit, shqyrtimit, analizës, shpjegimit dhe promovimit të dëshmimeve faktike, të cilat kanë ndryshuar vazhdimisht në përputhje me një kuadër të caktuar metodologjik brenda secilës periudhë në ndryshim nga një periudhë tjetër.

Në diskutime të ndryshme ngrihet, pa dyshim, edhe çështja e ideologjisë që qëndron në bazamentet e një regjimi të caktuar politik dhe që shihet shpesh si një ndikim i jashtëm, që thuhet se ka shtrembëruar metodat dhe rezultatet shkencore në albanologji. Kjo bën që ndokush të besojë se tani që jemi shkëputur nga ideologjia e së kaluarës atëherë edhe studimet shqiptare kanë hyrë detyrimisht në rrugën e duhur.

Gjatë shekujve XIX-XX, çështjet shqiptare zunë vend edhe në programet e njëpasnjëshme kulturore-ideologjike me karakter imperial-kolonialist dhe nacional-komunist të propagandës shtetërore, që ushqej në fillim nga rivaliteti influencues i Fuqive të Mëdha dhe më vonë nga vullneti afirmues i regjimeve shtetërore kombëtare në Shqipëri². Pikërisht në këto periudha, studimet shqiptare janë kapluar dora-dorazi nga deliret e antikuarizmit, autoktonisë, autenticitetit, prejardhjes, përparësisë dhe veçantisë ekskluzive, si dhe kanë përpunuar një sërë teorish mbi historinë, gjuhën, kulturën dhe shoqërinë shqiptare. Nga mesi i shekullit XX u përpunuan teori të reja mbi transformimet socialiste, revolucionarizimin e jetës dhe arritjet teknologjike e shkencore,

¹ Thomas Kuhn, *The structure of scientific revolutions*, 4th ed. (Chicago: University of Chicago Press, 1962; Repr., 2012).

² A. Doja, "Beautiful Blue Danube and Accursed Black Mountain Wreath."; Albert Doja, "From the German-speaking point of view: Unholy Empire, Balkanism, and the culture circle particularism of Albanian studies," *Critique of Anthropology* 34, no. 3 (2014): 290-326, <https://doi.org/10.1177/0308275X14531834>.

përfshi edhe “arritjen” e zhvendosjes së qendrës së albanologjisë nga albanologët e huaj te studiuesit vendës në Tiranë, që në fakt nuk ishte veçse kapitalizim i albanologjisë imperial-kolonialiste për ta shndërruar në albanologji nacional-komuniste.

Një numër i konsiderueshëm çështjesh, si preferenca e tezës ilirike apo pellazgjike të prejardhjes së popullit shqiptar, kodifikimi i normave zakonore, apo standardizimi dhe njësimi i drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe, nuk janë vetëm çështje shkencore, por para së gjithash çështje politike, të kushtëzuara nga pikësynimet imperial-kolonialiste austriake ose nacional-komuniste vendëse. Të tilla janë pa dyshim edhe racionalizimet shkencore të transformimeve socialiste gjatë komunizmit.

Teoria pellazgjike, për shembull, është përkrahur fillimisht gjatë shekullit XIX nga politika greke dhe italiane. Ndërkohë, një numër i konsiderueshëm studimesh kanë treguar tashmë një lloj ndërvarësie gjatë kësaj kohe në marrëdhëniet midis politikës hegjemoniste austro-hungareze dhe kërkimit shkencor albanologjik¹. Nuk është rastësi që në kushtet e rivalitetit të Austro-Hungarisë me Italinë në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, albanologët austriakë përdorën teorinë ilirike për t'i shërbyer politikës koloniale dhe ekspansioniste austriake, që kërkonte të

¹ e.g. Siegfried Gruber, "Austrian contributions to the ethnological knowledge of the Balkans since 1850," *Ethnologia Balkanica: Journal for Southeast European Anthropology* 2 (1998): 209-224; Karl Kaser, "Albania: Orientalisation and Balkanisation of a Balkan country: A contribution to a ongoing debate," in *Albania, a country in transition: aspects of changing identities in a South-East European country*, ed. Frank Kressing and Karl Kaser (Baden-Baden: Nomos, 2002): 27-38; Andreas Hemming, "German-speaking travel writers in interwar Albania," in *Albania: family, society and culture in the 20th century*, ed. Andreas Hemming, Gentiana Kera, and Enriketa Pandlejmoni (Münster: LIT-Verlag, 2012): 115-129; Christian Marchetti, *Balkanexpedition: die Kriegserfahrung der österreichischen Volkskunde: eine historisch-ethnographische Erkundung* (Tübingen: Tübinger Vereinigung für Volkskunde, 2013); Christian Promitzer, "Austria and the Balkans: Exploring the role of travelogues in the construction of an area," in *Southeast European Studies in a Globalizing World*, ed. Christian Promitzer, Siegfried Gruber, and Harald Heppner (Münster: LIT-Verlag, 2014): 189-206; A. Doja, "Beautiful Blue Danube and Accursed Black Mountain Wreath.," A. Doja, "From the German-speaking point of view.," Albert Doja, "Lindja e albanologjisë sipas shkrimeve gjermane dhe austriake," *Gjurmime Albanologjike: Folklor dhe Etnologji* 46 (2016): 9-40; Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918* (Wiesbaden: Springer, 2018, <https://doi.org/10.1007/978-3-658-18911-2>).

fitonte epërsi mbi Italinë dhe t'i kundërvihej depërtimit sllav në Ballkan.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, pushteti komunist në Shqipëri u bind për supremacinë e teorisë ilirike dhe nuk mundi të imponojë teorisë pellazgjike. Siç mëtohet shpesh, ishin pikërisht “prurjet koherente-rezultative” të elitës albanologjike që imponuan qysh në fillim tezën ilirike. Por me sa duket, si në rastin e mbështetjes politike imperial-austriake, edhe në rastin e promovimit nacional-komunist, përparësia shkencore e teorisë ilirike ndaj teorisë pellazgjike nuk bazohej domosdoshmërisht në kritere shkencore. Parë në retrospektivë, albanologët shqiptarë të edukuar në traditën austriake duket se janë shtrënguar të vazhdojnë përkrahjen e tezës ilirike, ndoshta, thjesht nga nevoja të domosdoshme të pragmatizmit material e politik, sepse përndryshe ose do kishin mbetur pa punë, ose mund të dilnin të panevojshëm për interesat publike të kohës.

Edhe kontributi shkencor i kodifikimit kishtar-katolik të normave kanunore prej Shtjefën Gjeçovit dhe rikodifikimi i tyre nacional-komunist në fund të regjimit totalitar, ashtu si dhe njësimi dhe standardizimi i gjuhës shqipe kanë pasur qëllime të qarta politike. Me fillimet e lëvizjes kombëtare, Kongresi i Manastirit në vitin 1908 i hapi rrugën përpjekjeve të rilindësve për njësimin e gjuhës e të alfabetit, në luftë me administratën otomane që përpiqej me çdo mjet ta pengonte këtë proces, ndërsa përpjekjet e para shtetërore dhe administrative për njësimin e gjuhës shqipe u kryen nga rrjeti diplomatik dhe administrata ushtarake austriake në kuadrin e asaj që njihet si Komisia Letrare Shqipe, e themeluar në vitin 1916 në Shkodër¹. Ashtu si lëvizja politike e Rilindjes Kombëtare apo rrjeti diplomatik dhe administrata ushtarake austriake, edhe fushata e fuqishme e aparatit të propagandës shtetërore nacional-komuniste krijoi kushtet për një standardizim të gjuhës shqipe si një domosdoshmëri politike mbarëkombëtare, që u kurorëzua me Konsultën e Prishtinës në vitin 1968 dhe me Kongresin e Drejtshkrimit në vitin 1972.

¹ Anila Omari, "Çështja e gjuhës së përbashkët shqipe dhe ndikimi i diplomacisë austro-hungareze," in *Austro-Hungaria dhe Shqipëria, 1916-1918*, ed. Dorian Koçi and Marenglen Kasmir (Tirana: MHK, 2019): 165-178.

Por, asnjë lloj pushteti shtetëror apo administrativ nuk mund të imponojë kriteret shkencore dhe të përcaktojë se si duhej të ishte dhe as se si u bë standardi i gjuhës letrare. Kështu është dhe kështu ka ndodhur, sepse nuk ka si të jetë ndryshe, edhe me të gjitha gjuhët e tjera të botës, që janë njësuar vetëm në saje dhe për nevoja të konsolidimit të pushtetit politik, siç është rasti i greqishtes së vjetër nën ndikimin e sundimit politik të Perikliut në Athinë apo rasti i frëngjishtes nën ndikimin e sundimit politik të François I.

Nëse përdorim termat e zhurmshëm që u bënë pjesë e kulturës popullore të asaj kohe, çështja kryesore që shtrohej për zgjidhje ishte ndërtimi i socializmit dhe transformimet socialiste. Pikërisht, pikësynimet ideologjike nacional-komuniste kanë acaruar edhe fiksimin e trashëguar me gjetjet që duhej të provojnë antikuarizmin dhe ekskluzivizmin e autoktonisë, autenticitetit dhe përparësisë kulturore me të cilat duhej të krenohemi. Por kjo qasje duhej edhe të transformohej për të luftuar dhe për të shkukur nga rrënjët primitivizmin dhe mbeturinat e prapambetjes kulturore, së bashku me bartësit e tyre. Kjo nënkuptonte formimin e njeriut të ri nacional-komunist dhe të shoqërisë së re “kombëtare në formë dhe socialiste në përmbajtje” (sipas formulës staliniste), spastrimin e historisë, imponimin e një gjuhe të standardizuar, luftën kundër zakoneve prapanike dhe mbeturinave fetare, si dhe zhdukjen e kundërshtarëve që konsiderohen armiq të popullit apo të prapambetur nga pikëpamja ideologjike e shoqërore, si dhe kulturore e gjuhësore¹. Këto dhe të tjera çështje të ngjashme nuk mundej të realizoheshin veçse prej një populli që është krenar për prejardhjen e tij, që e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë dhe që është shkencërisht i bindur për përparësinë dhe për domosdoshmërinë e rrugës që ka zgjedhur.

Nëse në kushtet e sotme këto procese politike janë shkencërisht të papranueshme dhe moralisht të dënueshme, për këtë janë përgjegjës edhe albanologët dhe hierarkia politike-shkencore e asaj

¹ Enika Abazi and Albert Doja, "From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism," *Communist and Post-Communist Studies* 49, no. 2 (2016): 163-178, <https://doi.org/10.1016/j.postcomstud.2016.04.002>; Nebi Bardhoshi and Olsi Lelaj, *Etnografi në diktaturë: Dija, Shteti dhe Holokausti ynë* (Tirana: Akademia e Shkencave, 2018).

kohe, që kanë ofruar rikodifikimin e traditave zakonore, standardizimin e gjuhës shqipe, si dhe përligjjen shkencore të fushatave të transformimeve socialiste. Me kontributin e tyre teorik e metodologjik, albanologët dhe hierarkia politike-shkencore e asaj kohe u treguan më të zotët për t'iu imponuar qysh në fillim aparatit shtetëror të propagandës ideologjike-nacionaliste dhe kanë konkretizuar ato prurje rezultative-koherente që i kanë shërbyer më mirë politikës nacional-komuniste. Madje, merita më e madhe e atyre studuesve është se kanë ditur të përshtatin me shumë mjeshtëri studimet e tyre ndaj ideologjisë që kërkonte koha e tyre. Kjo i ka shndërruar ata dhe jo të tjerët në një rreth të ngushtë elitar të përkrahur nga pushteti komunist.

Pushteti komunist imponoi kushtet për trajtimin shkencor të mbarë çështjeve shqiptare, por cilat teori dhe metoda duhej të përdoren dhe çfarë prurjesh rezultative-koherente ishin të domosdoshme në përputhje me ideologjinë nacional-komuniste, kjo nuk mund të imponohej nga pushteti komunist. Studimet shqiptare kanë arritur majat më të larta pikërisht sepse problemet shkencore që ato kanë trajtuar u përputhën plotësisht me paradigmën e tyre shkencore. Në këtë kuptim, prurjet e studimeve albanologjike nuk mund të jenë veçse koherente-rezultative për atë kuadër metodologjik e ideologjik të trajtimit të tyre, që përcaktohet nga kushtet politike dhe shtetërore të kohës apo të vendit kur u lindën, u praktikuan dhe u zhvilluan.

Kështu për shembull, standardizimi dhe njësimi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe nuk ka të bëjë me natyrën e regjimit të pushtetit komunist, përkatësisht totalitar e diktatorial, ashtu si dhe nuk ka një “diktaturë” të standardit të gjuhës së njësuar që bën të mundur mbijetesën e dinamikave komunikuese në kushtet e një shoqërie të lirë pa diktaturën shtetërore. Thjesht, drejtshkrimi i një gjuhe letrare të njësuar është detyrimisht pjesë përbërëse e proceseve shtetformuese dhe kombformuese që përshpejtohen në kushtet e një pushteti politik të konsoliduar. Në këtë kuptim, jo vetëm është naive të mendohet se gjuha e njësuar është “diktaturë” e një dialekti krahinor mbi një dialekt tjetër krahinor, por edhe orvatjet e moderuara apo të zhurmshme për të vënë në diskutim arritjet e drejtshkrimit të gjuhës së njësuar nuk dëshmojnë vetëm rënien e

autoritetit diktatorial e totalitar të regjimit komunist. Pavarësisht nga forma e regjimit, proceset shtetformuese dhe kombformuese përfshijnë dhe nuk përjashtojnë përpjekjet për ndryshime cilësore të vazhdueshme, që janë pa dyshim të shumta dhe të lavdërueshme, kur synojnë mirëmbajtjen dhe pasurimin e gjuhës së njësuar me prurjet dialektore dhe krahinore. Gjithashtu, përpjekje të tilla përfshijnë dhe nuk përjashtojnë pluralizmin politik, lirinë e shprehjes dhe të fjalës, apo diversitetin social e kulturor, kur synojnë përforcimin e proceseve shtetformuese dhe kombformuese në kuadrin e një forme të re të regjimit politik, përkatësisht demokratik.

Përputhja dhe mospërputhja kërkimore me paradigmën shkencore

Nga pikëpamja e epistemologjisë kritike, prurjet kërkimore të studimeve shqiptare nuk diskutohen për cilësinë e tyre, por duhen vlerësuar në radhë të parë nga qasjet teorike dhe zgjedhjet metodologjike që diktohen domosdoshmërisht nga premiset e ndryshme politike dhe ideologjike. Studiues të nderuar vendës e të huaj, gjatë shekujve XIX-XX, nuk kanë qenë aspak kolonialistë, as kolaboracionistë dhe as komunistë. Megjithatë, formimi dhe zhvillimi i bindjeve të tyre intelektuale-shkencore është mundësuar domosdoshmërisht brenda një kuadri filozofik e botëkuptimor që është përcaktuar ose nga premiset imperial-kolonialiste apo nazifashiste, ose nga premiset nacional-komuniste.

Pikërisht, premiset ideologjike dhe kushtet politike të njërit apo tjetrit kuadër filozofik e botëkuptimor kanë diktuar si problematikat shkencore, ashtu edhe zgjedhjet e tyre teorike dhe metodologjike, që lidhen sipas rastit ose me antikuarizmin esencialist të prejardhjes, autoktonisë, autenticitetit dhe përparësisë, ose me transformimet socialiste të historisë, gjuhës, kulturës dhe shoqërisë shqiptare, ose me të gjitha së bashku¹. Këto kanë kufizuar edhe metodat e përdorura për kërkimin dhe gjetjen, si dhe për grumbullimin, evidentimin dhe sistematizimin pa fund të atyre dëshmime empirike,

¹ Albert Doja, "From the native point of view: An insider/outsider perspective on folkloric archaism and modern anthropology in Albania," *History of the Human Sciences* 28, no. 4 (2015): 44-75, <https://doi.org/10.1177/0952695115594099>.

faktike, filologjike apo folklorike, që janë nevojitur për verifikimin apo për kundërshtimin e disa argumenteve të gatshme dhe jo të tjerave. Në këtë kuadër, imagjinata shkencore krahasuese dhe qasjet kritike analitike që mundësojnë shpjegime shkencore teorike sipas disiplinave përkatëse nuk janë të nevojshme. Prandaj, studimet shqiptare janë karakterizuar nga tipare të tilla si empiricizmi, teknikizmi, historicizmi, folkloricizmi etj.

Në studimin e shprehjeve të ndryshme të sjelljes shoqërore e të kulturës materiale, artistike, gojore apo letrare, ka një ndryshim të madh kur synojmë të japim një përshkrim sado të hollësishëm e shterues të tipareve karakterizuese dhe të huazimeve të mundshme për të përcaktuar origjinën dhe variantin burimor e më të hershëm; apo përkundrazi, siç ka treguar Claude Lévi-Strauss lidhur me studimin e miteve, nëse synojmë të zbulojmë qëllimin e aktorëve dhe mesazhin që komunikojnë produktet kulturore, për të shpjeguar përse njerëzit krijojnë këto apo ato produkte kulturore dhe jo të tjera.

Edhe në studimet historike në përgjithësi, ashtu si dhe në studimet e veçorive krahinore dhe historike të traditave kulturore në veçanti, ka një ndryshim të madh nëse nisemi nga “programi folklorik” që gjen shprehje në mitin antikuarist dhe në dëshmitë e supozuara të autoktonisë dhe të përparësisë së gjuhës, të kulturës dhe të “gjakut” apo “shpirtit” popullor e kombëtar të shqiptarëve; apo përkundrazi, siç kanë treguar punimet e antropologut të njohur norvegjez Fredrik Barth dhe të kolegëve të tij, nisemi nga ato procese historike, gjuhësore, kulturore, shoqërore dhe politike të cilat kanë bërë të mundur që dallimet kulturore të pësojnë një riorganizim shoqëror kufindarës e kufitregues¹, i cili shpjegon më së miri formimin e identitetit shqiptar dhe transformimet identitare në territoret ku është folur shqipja dhe është formuar kultura që konsiderohet si shqiptare, siç kam treguar për shembull lidhur me rolin kufindarës të konvertimeve fetare dhe ndërrimeve

¹ Fredrik Barth, ed., *Ethnic groups and boundaries: the social organization of culture difference* (London: Allen & Unwin, 1969).

etnonimike¹, apo të gjuhës shqipe në kontekstin e rivalitetit të trysnive klerikale dhe politike².

Po kështu, me sa kuptoj nga diskutimet me kolegët gjuhëtarë, ka një ndryshim të madh nëse për trajtimin shkencor të të njëjtit problem gjuhësor nisemi nga kritere morfologjike apo nga kritere semantike, si dhe nëse mbështetemi mbi qasjet filologjike apo mbi qasjet sintaksore. Në rastin e parë, parimi morfologjik apo filologjik mjaftohet me qasjet deskriptiviste, sado gjithëpërfshirës të jetë përshkrimi i lëndës gjuhësore, ndërsa në rastin e dytë, parimet semantike apo sintaksore mund të jenë më të vështira, por japin më shumë dorë për imagjinatë shkencore dhe qasje analitike të materialit gjuhësor. Afërmendsh, edhe për vlerësimin e studimeve shqiptare në përgjithësi, ka ndryshim nëse nisemi nga evidentimi i qasjeve, prurjeve apo tematikave shkencore sipas disiplinave përkatëse; apo përkundrazi, si në rastin e këtushëm, përipiqemi t'i rrokim ato në mënyrë sintetizuese nga pikëpamja e artikulimit të tyre në përputhje me paradigmen shkencore dhe kuadrin e tyre metodologjik e filozofik.

Pra, nëse ka një problem me studimet shqiptare, ky nuk ka të bëjë aspak me qasjet dhe prurjet shkencore në fushat disiplinore përkatëse, por me paradigmen albanologjike që konsiderohet shpesh në mënyrë ahistorike si e pandryshueshme dhe e amshuar, me sa duket nga që çështjet e autoktonisë apo identitetit të bashkësisë kombëtare dhe shtetërore shqiptare janë të rëndësishme dhe të përhershme.

Përpjekjet për ndryshime cilësore janë të vazhdueshme dhe të shumta, si dhe pa dyshim të lavdërueshme. Por a mund të thuhet se studimet shqiptare kanë hyrë në një fazë të re, më cilësore dhe më dinjitoze në përputhje me kërkesat bashkëkohore? Me sa duket, karakteri i përkohshëm i paradigmës shkencore dhe kuadrit ideologjik e metodologjik të studimeve shqiptare dhe mospërputhja e herëpashershme me kushtet e kohës duhet të ketë shkaktuar në

¹ Albert Doja, "The politics of religion in the reconstruction of identities: the Albanian situation," *Critique of Anthropology* 20, no. 4 (2000): 421-438, <https://doi.org/10.1177/0308275X0002000404>.

² Albert Doja, "Ecclesiastical pressures and language politics: The boundary work of Albanian language in the 17th-18th centuries," *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* 50, no. 4 (2022): 742-769, <https://doi.org/10.1017/nps.2021.55>.

mënyrë të përsëritur edhe vënien në pikëpyetje të çështjeve shqiptare.

Kështu duket se po ndodh në kushtet e sotme, për shembull, me trashëgiminë kulturore të normave kanunore, kur shpesh hidhet poshtë si kodifikimi kishtar-katolik i këtyre normave prej Gjeçovit, ashtu edhe rikodifikimi nacional-komunist i tyre prej albanologëve të mëvonshëm, duke mëtuar hera-herës risjelljen e origjinës burimore islamike-otomane, justifikimin instrumental të veprimtarive kriminale, apo trajtimin pluralist në kushtet e sotme ideologjike-juridike. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për orvatjet që synojnë rishikimin e standardizimit dhe njësimin të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, të cilat duket se përsëri nuk kanë të bëjnë aspak me ndryshime të karakterit kërkimor e shkencor gjuhësor, por me ndryshime të karakterit politik e ideologjik. Pikërisht, pikësnyimi kryesor i orvatjeve të tilla është të vënë në pikëpyetje dhe, në fakt, ato përpiqen të zhbëjnë procesin politik të standardizimit nacional-komunist të gjuhës letrare, që konsiderohet si një rezultat i pushtetit diktatorial e totalitar të kohës. Edhe pse këto paraqiten si orvatje shkencore apo të moderuara, si dhe sado shkencore e të moderuara qofshin, ka gjasa që këto lloj orvatjesh afrohen më shumë me përpjekjet otomaniste për të penguar njësimin e alfabetit dhe mësimin e gjuhës shqipe që përkrahej nga lëvizja politike e Rilindjes Kombëtare.

Procese të tilla ndodhin edhe gjetiu, si për shembull në Francë, ku në kushtet e shkërmoqjes së padallueshme të shtetit dhe nën presionin e vazhdueshëm të ideologjive gjinore radikale ka filluar shkatërrimi i drejtshkrimit të gjuhës frëngjishte nëpërmjet një lloj shkrimi të quajtur inkluziv¹. Në rastin tonë, këto lloje hamendësimesh mund të jenë ekzagjerime të papranueshme, thjesht sepse nuk jemi në gjendje të shohim ndonjë agjenci politike apo ideologjike prapa orvatjeve të tilla. Por procese të tilla tregojnë se deri në çfarë mase studimet shqiptare janë çoroditur sa herë u është dashur ta fillojnë nga e para trajtimin e problemeve të tyre

¹ Albert Doja, "La *leçon d'écriture et la violence de la lettre: de la généalogie de la déconstruction à l'instrument politiquement excluant de l'écriture inclusive*," in *After the Deconstruction: L'Université au défi des nouvelles idéologies*, ed. Emmanuelle Hénin, Xavier-Laurent Salvador, and Pierre-Henri Tavoillot (Paris: O.Jacob, 2023): 39-49.

shkencore. Konkretisht kjo ka ndodhur sa herë që ka ndryshuar kuadri botëkuptimor, për të kaluar nga ideologjia imperial-kolonialiste tek ideologjia nazifashiste dhe tek ideologjia nacional-komuniste. Në mënyrë edhe më të dukshme procese të tilla po ndodhin si rezultat i tranzicionit nga ideologjia nacional-komuniste tek ideologjia postkomuniste.

Orvatjet për rishikimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ashtu si dhe bjerrjet e vazhdueshme dhe zvetënimet e praktikimit të gjuhës së njësuar dhe të sjelljes gjuhësore standarde, sidomos në rrjete sociale dhe në mediet televizive, mund të konsiderohen fare mirë në kuadër të anarkisë shoqërore, kulturore dhe ideologjike, si rrjedhojë e shpërdorimit të lirisë dhe të drejtave themelore demokratike, që në fushë të komunikimit dhe të drejtshkrimit e drejtshqiptimit të gjuhës dikush mund ta quajë edhe si “anarki gjuhësore”. Sidoqoftë, ato nuk mund të jenë gjë tjetër veçse një shprehje e shkërmoqjes së padallueshme, por regresive të proceseve shtetformuese dhe kombformuese, si dhe të mbarë sistemit politik e ideologjik të vlerave shoqërore e kulturore kombëtare, gjatë kësaj periudhe të ashtuquajtur tranzicionale.

Në kushtet e sotme, paradigma shkencore e studimeve shqiptare kërkon, para së gjithash, një kritikë gjenealogjike radikale, si hap i domosdoshëm në rrugën e vetme për t’u shkëputur plotësisht e përfundimisht nga trashëgimia ideologjike që vjen nga përfaqësuesit e vjetër e të rinj të mënyrave të vjetruara të shkencërimit. Nëse paradigma albanologjike ka vazhduar e pandryshuar ashtu si është trashëguar nga shekujt XIX-XX, atëherë është i domosdoshëm një revolucion shkencor, në mënyrë që paradigma shkencore e studimeve shqiptare të ndryshojë e të transformohet shkallëshkallshëm në përputhje me kuadrin e ri metodologjik, filozofik e ideologjik të shekullit XXI.

Ndonëse “falsifiabiliteti” apo përgënjeshtrimi shkencor sipas Karl Popper-it është thjesht një procedurë që shërben për të quajtur të vlefshme metodën dhe rezultatet e kërkimit, koncepti i revolucionit shkencor sipas Thomas Kuhn-it nuk është i njëjtë me revolucion politik, si për shembull te revolucioni francez, revolucioni sovjetik, revolucioni kulturor apo revolucioni islamik. Prandaj, nëse revolucioni politik bëhet nëpërmjet mobilizimit të

masave, revolucionit shkencor nuk merret as nga Thomas Kuhn-i, as bëhet me vota në mbledhjet e Akademisë. Në këtë kuptim, nuk mund të flitet për “shkëputje” të studimeve shqiptare nga ky apo ai kuadër ideologjik e filozofik, sepse qasjet dhe prurjet shkencore në këto fusha nuk janë të ideologjizuara nga jashtë, apo nuk janë të ideologjizuara domosdoshmërisht nga ideologjia shtetërore e një regjimi të caktuar politik. Ato përcaktohen nga premiset e një paradigme të caktuar shkencore, që nuk është e njëjta gjë dhe nuk varet drejtpërdrejt nga ideologjia politike. Të dyja janë ideologji dhe pjesë përbërëse të një sistemi shoqëror, që ndikojnë njëra-tjetrën, por nuk janë e njëjta gjë.

Revolucioni shkencor nuk ka nevojë për deklamime emfatike mbi domosdoshmërinë e hulumtimeve dhe qasjeve konkrete e të detajuara të prurjeve dhe gjetjeve në kërkimet shkencore, për t’u çliruar nga faktorët ideologjikë, sepse në kushtet e sotme praktikisht nuk jemi të qartë se cilët janë këta faktorë ideologjikë që duhen luftuar e mënjanuar. Sigurisht, jemi të qartë për faktin se kuadri i dikurshëm ideologjik nacional-komunist tashmë konsiderohet i kapërcyer, por studimet shqiptare vazhdojnë të trajtojnë njëllot të njëjtat probleme. Me sa duket, akoma nuk e kemi gjetur pse duhet të kemi një kuadër të ri dhe cili duhet të jetë ky kuadër që duhet t’u japë një drejtim të ri studimeve shqiptare, madje akoma nuk e dimë se çfarë kuptojmë me këtë dhe akoma nuk e kemi të qartë se çfarë duhet të kërkojmë dhe si ta kërkojmë e ta gjejmë. Ajo çka përbën problem lidhet pikërisht me mospërputhjen e paradigmës shkencore dhe kuadrit metodologjik, filozofik e ideologjik, me problemet shkencore që trajtohen nga studimet shqiptare.

Imperializmi metodologjik

Ndërgjegjësimi i një kuadri të ri ideologjik dhe filozofie të kërkimit shkencor kthehet në domosdoshmëri për studimet shqiptare, sidomos në kushtet kur në tregun botëror të ideologjive ka edhe një mori modelesh të gatshme paradigmatiche. Në kushtet e çoroditjes së përgjithshme botëkuptimore që ka pësuar shoqëria shqiptare në këto 30 vitet e fundit, kuadrin e zbrazët ideologjik e kanë zënë ideologjitë tranzitologjike, postmoderniste apo fundamentaliste. Një sërë studiuesish të rinj kanë përqafuar edhe

paradigmat majtiste-ekstremiste të dekolonializmit, dekonstruksionizmit, çmitizimit, multikulturalizmit, ultraliberalizmit, neofeminizmit, neoekologjizmit, apo pseudoprogresivizmit. Ekstremizma të tjerë edhe më absurdë shfaqësojnë dhe risjellin në rend të ditës ideologjitë komuniste, nganjëherë edhe nëpërmjet kujtimeve zbavitëse, por të qarta dhe serioze të një fëmijërie staliniste me pjekurinë e shkollarisë majtiste radikale, që përpiqet të shesë “lirinë” staliniste për çlirim të njerëzimit.¹ Të tjerë promovojnë gjithfarë ideologjish antikombëtare nëpërmjet krahinorizmave, fetarizmit, islamizmit dhe otomanizmit.

Veçmas apo të kombinuara, këto lloje ideologjish janë ndoshta edhe më të rrezikshme. Nëse kuadri i mëparshëm ideologjik u nënshtrohej interesave të caktuar të pushtetit dhe të qeverisjes imperial-kolonialiste apo nacional-komuniste, ideologjitë e reja nuk përpiqen të studiojnë, as të analizojnë dhe as të shpjegojnë, por të shkërmoqin gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare. Siç kam argumentuar gjetiu, synimi i tyre kryesor është më tepër të mësojnë një brez të tërë studiuesish të rinj me teknologjitë postmoderniste të dekonstruktivizmit, se si të çmishërojnë dhe të anulojnë identitetin shqiptar, të shkulturojnë dhe të shpolitizojnë kombin shqiptar, të parandalojnë perspektivat alternative të njerëzve të zakonshëm dhe përfundimisht të çndërtojnë dhe të shkatërrojnë mbarë shoqërinë shqiptare.² Nëse bëhet thirrje për tejkalimin e kombit shqiptar, ndërkohë që për shumicën e shqiptarëve kombi u siguron të vetmin kuadër interpretues të rëndësishëm, kjo bëhet për t’ua mbyllur gojën, apo për t’ua anuluar historinë, kulturën dhe shoqërinë. Në mënyrë të ngjashme, nëse turbullohet tradita e studimeve shqiptare, kjo mund të shërbejë fshehtëazi për justifikimet esencialiste të një politikë të mëtejshme identitetare në emër të motiveve ekskluziviste edhe më të papranueshme.

Në fakt, akoma më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm bëhet përpunimi i vetëdijshtëm i një paradigme shkencore dhe kuadri

¹ Shih, për shembull: Lea Ypi, *Free: Coming of Age at the End of History* (London: Allen Lane, 2021), *Free: A Child and a Country at the End of History* (New York: W.W.Norton, 2022); Botuar edhe në shqipe (Tirana: Dudaj, 2021).

² Shih: Albert Doja, "Tjetërsimi strategjik i historisë shqiptare në shkrimet e një historianeje franceze," in *Les études sur les Albanais en France*, ed. Rexhep Ismajli, Academia Scientiarum et Artium Kosoviensis (Pristina: ASHAK, 2022): 413-440.

metodologjik e filozofik për studimet shqiptare në kushtet e imperializmit metodologjik të rrjetit të marrëdhënieve midis agjencive shtetërore e joshtetërore dhe aktorëve institucionalë e individualë të shkollarisë ndërkombëtare që ndikojnë në mënyra të ndryshme mbi drejtimit e praktikës dhe zhvillimit të studimeve shqiptare¹. Në këtë kontekst, format e reja të topografive postkolonialiste dhe postsocialiste të pushtetit dhe të ekspertizës shkencore mbështeten nga regjime të reja transnacionale, organizatave humanitare dhe institucioneve ndërkombëtare, që përfshijnë edhe segmente të caktuara të hierarkive vendëse politike-mediatiqe-shoqatore. Këto transferohen në fushën politike të pushtetit dhe vepronë në rrjete që përhapen në të gjitha sferat private dhe publike, duke u maskuar prapa fjalimeve të europianizimit, modernizimit, liberalizimit dhe demokratizimit, që janë tipike për retorikën tranzitologjike globale. Edhe fjalimet mbi anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian riprodhojnë një terren që tradicionalisht kuptohet si periferi e Europës, që ka nevojë për mbikëqyrje, udhëzime dhe trajnime prej Perëndimit, por edhe shërben si kosh plehrash për emigrantët e padëshiruar të Europës. Ky kontekst riaktualizon modelet e njohura imperial-kolonialiste që mundësojnë një hierarki të re politike-shkencore, nga jashtë brenda vendit, që artikulon hapur dhe përvetëson një traditë të re të primitivizmit neokolonialist.

Në këto kushte, studimet shqiptare rigjallërojnë ato atraksione kulturore të një vendi dhe një populli të harruar që tani, pas përmbysjes së komunizmit, paska hequr qafe obskurantizmin e dikurshëm ideologjik. Një qasje e tillë e rivendos Shqipërinë, ashtu si mbarë Ballkanin, në një zonë tampon midis Perëndimit dhe të tjerëve. Postkomunizmi shoqërohet me një të kaluar të largët dhe ekzotike, ashtu si dhe me lloje të ndryshme të konservatorizmit politik, kulturor e shoqëror, të tradicionalizmit estetik dhe të nacionalizmit romantik, gjithnjë joeuropiane dhe jomoderne, por tipike për një postkolonialitet të ri. Në këtë kontekst, studiuesit e

¹ Albert Doja, "The New German-speaking School of *Balkankompetenzen*: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context," *New Perspectives: Interdisciplinary Journal of Central & East European Politics and International Relations* 30, no. 1 (2022): 87-118, <https://doi.org/10.1177/2336825X211065569>.

huaj e mbajnë veten të lidhur me progresin civilizues dhe qendrat metropolitane të Perëndimit, ndërsa studiuesit vendës dashur padashur marrin pjesë në mënyrë të pavetëdijshme në përforcimin e ekzoticizimit vetëkolonizues.

Kështu, shqiptarët bëhen objekt i ekzoticizmit sensacional dhe primitivizmit poshtërues, madje studiuesit vendës mund të trajtohen në mënyrë përçmuese edhe si “virgjëresha në bordello”¹, për të thënë metaforikisht se puna kërkimore në institucionet vendëse nuk përputhet me studimet që kryhen në institucionet perëndimore. Gjithashtu, keqinterpretime të shpeshta krijohen për mitet krijuese, si për shembull me figurën e Skënderbeut², për historinë kombëtare, siç ka ndodhur me karakterizimin e lindjes së një kombi mysliman në mes të Europës³, për strukturat shoqërore, siç është rasti me përgjithësimin e tipareve të familjes patriarkale⁴, apo për sjelljen kulturore, siç ndodh me normat zakonore arkaike⁵. Gjithnjë, çështjet shqiptare trajtohen mbi bazën e paragjytimeve dhe kundërshtimit të tyre, çka parapërcakton që në krye të herës si qasjet, edhe prurjet shkencore. Reagimi kundërshtues i studimeve vendëse ndaj studimeve të paragjykuara artikullohet shpesh nën maskën e një kulture kombëtare që kërkon në mënyrë agresive t'u përshtatet vlerave të Europës Perëndimore, por dashur padashur, shumë studiues vendës përjetësojnë vazhdimisht thelbin folklorik të filologjisë historike dhe antikuarizmin e prejardhjes, autoktonisë, autenticitetit, përparësisë dhe veçantisë, që janë tipike të paradigmes së vjetruar albanologjike.

¹ Stephanie Schwandner-Sievers, "Jungfrauen und Elefanten im Porzellanladen: Zur internationaler Herausforderung der albanischen Ethnologie im Postsozialismus," in *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung*, ed. Oliver-Jens Schmitt (München: Oldenbourg, 2009): 187-214.

² Oliver-Jens Schmitt, *Skanderbeg: der neue Alexander auf dem Balkan* (Regensburg: Pustet, 2008).

³ Nathalie Clayer, *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe* (Paris: Karthala, 2007; Repr., 2018).

⁴ Karl Kaser, "Family and Kinship in Albania: Continuities and Discontinuities in Turbulent Times," in *Legacy and Change: Albanian Transformation from Multidisciplinary Perspectives*, ed. Robert Pichler (Münster: LIT-Verlag, 2014): 97-115.

⁵ Stephanie Schwandner-Sievers, "The enactment of tradition: Albanian constructions of identity, violence and power in times of crisis," in *Anthropology of violence and conflict*, ed. Bettina Schmidt and Ingo Schroder (London: Routledge, 2001): 97-120.

Këtu nuk kemi të bëjmë me një situatë të thjeshtë krypto-koloniale, sepse si krenaria kombëtare e esencjalizmit kulturor në studimet vendëse, ashtu edhe dekonstruktivizmi stereotipizues i trashëgimisë historike dhe kulturore shqiptare nga disa studiues perëndimorë, janë një shenjë e domosdoshmërisë politike dhe ideologjike. Kjo vërtetohet dukshëm nga retorika tranzitologjike e proceseve modernizuese dhe europianizuese në fjalimet dhe praktikën e aktorëve ndërkombëtarë ndaj Shqipërisë dhe studimeve shqiptare. Me këtë nuk dua të them që studiuesit perëndimorë mbështetin në mënyrë të vetëdijshme politikën shtetërore, por disa prej prurjeve shkencore perëndimore kanë ngjashmëri me rrëfimet që kanë riprodhuar standardin historik të studimeve imperial-kolonialiste apo kanë shërbyer për të përligjur ndërhyrjet e politikës ndërkombëtare në Ballkan. Tek e fundit, disa prej tyre mund të jenë një vazhdim i hierarkive të vjetra shkencore, si dhe pjesë e të njëjtit spektër të diskutimeve, praktikave dhe instrumenteve të ndërhyrjes, që përdoren në emër të standardeve ideologjike demokratike dhe akademike, të cilat u shërbejnë interesave primarë të aktorëve perëndimorë për ruajtjen e hegjemonisë shkencore dhe politike.

Përfundime

Në këto kushte, më duket e papranueshme që forcat më të përgatitura shkencore janë të gozhduara nga paradigma antikuariste e shek. XIX dhe merren akoma me verifikimin e prejardhjes, autoktonisë, autenticitetit, përparësisë dhe veçantisë së një historie, kulture dhe shoqërie të imagjinuar. Ky qëndrim i ka vetizoluar dhe vazhdon t'i vetizojë studimet shqiptare në ideologjitë e vjetruara albanologjike, si një shkencë përjashtueshmërisht shqiptare vetëm për të përkëdhelur sedrën e shqiptarëve. Për më tepër, rimarrja pa fund e çështjeve të tilla, si për verifikimin, ashtu edhe për kundërshtimin e teorive të njohura, vë në pikëpyetje dhe diskrediton vetëqenësinë dhe dobinë e studimit të tyre.

Ndërkohë, mund t'i hapet rrugë deprovincializimit dhe integritit të studimeve shqiptare në shkencën ndërkombëtare nëpërmjet imagjinatës shkencore krahasuese dhe një kontributi të dallueshëm kritik, teorik e analitik në disiplinën përkatëse. Studimet

shqiptare mund të dallohen jo vetëm thjesht për trajtimin dhe evidentimin, por edhe për shpjegimin analitik e kritik, si të formimit historik, ashtu edhe të rolit dhe funksionit aktual të identitetit të bashkësisë shqiptare, duke u riorientuar nga problemet dhe sfidat e historisë, kulturës dhe shoqërisë reale. Konkretisht, imagjinata shkencore krahasuese për trajtimin kritik e analitik të implikimeve politike e ideologjike mundëson të kuptohen dhe të shpjegohen traditat kulturore dhe dukuritë e shoqërisë shqiptare në kohët e sotme, si dhe të mënjanoen gjithfarë partizanizmash krahinoriste, dialektaliste e fetariste, që lulëzojnë në dëm të konsolidimit si të shtetit edhe të gjuhës e të kulturës kombëtare.

Për këtë qëllim, grumbullimi i të dhënave empirike sipas disiplinave shkencore përkatëse duhet disiplinuar me filozofinë e shkencës dhe me logjikën e kërkimit shkencor në përgjithësi. Këtu nuk është fjala për ndonjë viktimizim nacionalist, as për të hedhur poshtë filozofinë kombëtare në studimet shqiptare, por, përkundrazi, për një strategji të vullnetshme që të vihen në plan të parë zgjedhjet teorike dhe metodologjike, imagjinata shkencore dhe vizioni botëkuptimor se si duhet t'i zhvillojmë studimet shqiptare në përputhje me përfytyrimet për shoqërinë shqiptare në të ardhmen. Kjo duhet të krijojë kushte edhe për mobilizimin e shqiptarëve brenda vendit dhe në diasporë rreth një projekti politik, shoqëror, kombëtar e qytetërimor, në mënyrë që t'i bashkojë dhe t'u japë kuptim e vendosmëri në kërkim të interesave të përbashkëta. Besoj, më shumë se për këdo tjetër, ky pikësynim është detyrë dhe përgjegjësi e aktorëve të studimeve shqiptare.

Referenca bibliografike

Abazi, Enika, and Albert Doja. "From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism." *Communist and Post-Communist Studies* 49, no. 2 (2016): 163-178. <https://doi.org/10.1016/j.postcomstud.2016.04.002>.

Bardhoshi, Nebi, and Olsi Lelaj. *Etnografi në diktaturë: Dija, Shteti dhe Holokausti ynë*. Tirana: Akademia e Shkencave, 2018.

Barth, Fredrik, ed. *Ethnic groups and boundaries: the social organization of culture difference*. London: Allen & Unwin, 1969.

Clayer, Nathalie. *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*. Paris: Karthala, 2007. Reprint, 2018.

Doja, Albert. "The politics of religion in the reconstruction of identities: the Albanian situation." *Critique of Anthropology* 20, no. 4 (2000): 421-438. <https://doi.org/10.1177/0308275X0002000404>.

Doja, Albert. "The Beautiful Blue Danube and the Accursed Black Mountain Wreath: German and Austrian Kulturpolitik of Knowledge on Southeast Europe and Albania." *Soziale Welt: Zeitschrift für sozialwissenschaftliche Forschung und Praxis* 65, no. 3 (2014): 317-343. <https://doi.org/10.5771/0038-6073-2014-3-317>.

Doja, Albert. "From the German-speaking point of view: Unholy Empire, Balkanism, and the culture circle particularism of Albanian studies." *Critique of Anthropology* 34, no. 3 (2014): 290-326. <https://doi.org/10.1177/0308275X14531834>.

Doja, Albert. "From the native point of view: An insider/outsider perspective on folkloric archaism and modern anthropology in Albania." *History of the Human Sciences* 28, no. 4 (2015): 44-75. <https://doi.org/10.1177/0952695115594099>.

Doja, Albert. "Lindja e albanologjisë sipas shkrimeve gjermane dhe austriake." *Gjurmime Albanologjike: Folklor dhe Etnologji* 46 (2016): 9-40.

Doja, Albert. "Ecclesiastical pressures and language politics: The boundary work of Albanian language in the 17th-18th centuries." *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* 50, no. 4 (2022): 742-769. <https://doi.org/10.1017/nps.2021.55>.

Doja, Albert. "The New German-speaking School of Balkankompetenzen: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context." *New Perspectives: Interdisciplinary Journal of Central & East European Politics and International Relations* 30, no. 1 (2022): 87-118. <https://doi.org/10.1177/2336825X211065569>.

Doja, Albert. "Tjetërsimi strategjik i historisë shqiptare në shkrimet e një historiane franceze." In *Les études sur les Albanais en France*, edited by Rexhep Ismajli. Academia Scientiarum et Artium Kosoviensis, 413-440. Prishtina: ASHAK, 2022.

Doja, Albert. "La leçon d'écriture et la violence de la lettre: de la généalogie de la déconstruction à l'instrument politiquement excluant de l'écriture inclusive." In *After the Deconstruction: L'Université au défi des nouvelles idéologies*, edited by Emmanuelle Hénin, Xavier-Laurent Salvador and Pierre-Henri Tavoillot, 39-49. Paris: O.Jacob, 2023, https://youtu.be/CE4zsNnn_uU.

Gostentschnigg, Kurt. *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Wiesbaden: Springer, 2018. <https://doi.org/10.1007/978-3-658-18911-2>.

Gruber, Siegfried. "Austrian contributions to the ethnological knowledge of the Balkans since 1850." *Ethnologia Balkanica: Journal for Southeast European Anthropology* 2 (1998): 209-224.

Hemming, Andreas. "German-speaking travel writers in interwar Albania." In *Albania: family, society and culture in the 20th century*, edited by Andreas Hemming, Gentiana Kera and Enriketa Pandelejmoni, 115-129. Münster: LIT-Verlag, 2012.

Kaser, Karl. "Albania: Orientalisation and Balkanisation of a Balkan country: A contribution to a ongoing debate." In *Albania, a country in transition: aspects of changing identities in a South-East European country*, edited by Frank Kressing and Karl Kaser, 27-38. Baden-Baden: Nomos, 2002.

Kaser, Karl. "Family and Kinship in Albania: Continuities and Discontinuities in Turbulent Times." In *Legacy and Change: Albanian Transformation from Multidisciplinary Perspectives*, edited by Robert Pichler, 97-115. Münster: LIT-Verlag, 2014.

Kuhn, Thomas. *The structure of scientific revolutions*. 4th ed. Chicago: University of Chicago Press, 1962. Reprint, 2012.

Lévi-Strauss, Claude. "The Structural Study of Myth." *Journal of American Folklore* 68, no. 270 (1955): 428-444. <https://doi.org/10.2307/536768>.

Lévi-Strauss, Claude. *Le Cru et le Cuit*. Mythologiques. Vol. 1. Paris: Plon, 1964.

Lévi-Strauss, Claude. *L'homme nu*. Mythologiques. Vol. 4. Paris: Plon, 1971.

Lévi-Strauss, Claude. *Le regard éloigné*. Paris: Plon, 1983.

Marchetti, Christian. *Balkanexpedition: die Kriegserfahrung der österreichischen Volkskunde: eine historisch-ethnographische Erkundung*. Tübingen: Tübinger Vereinigung für Volkskunde, 2013.

Omari, Anila. "Çështja e gjuhës së përbashkët shqipe dhe ndikimi i diplomacisë austro-hungareze." In *Austro-Hungaria dhe Shqipëria, 1916-1918*, edited by Dorian Koçi and Marenglen Kasmi, 165-178. Tirana: MHK, 2019.

Popper, Karl. *The logic of scientific discovery*. New York: Basic Books, 1959. Reprint, London/New York: Routledge, 1992.

Promitzer, Christian. "Austria and the Balkans: Exploring the role of travelogues in the construction of an area." In *Southeast European Studies in a Globalizing World*, edited by Christian Promitzer, Siegfried Gruber and Harald Heppner, 189-206. Münster: LIT-Verlag, 2014.

Schmitt, Oliver-Jens. *Skanderbeg: der neue Alexander auf dem Balkan*. Regensburg: Pustet, 2008.

Schwandner-Sievers, Stephanie. "The enactment of tradition: Albanian constructions of identity, violence and power in times of crisis." In *Anthropology of violence and conflict*, edited by Bettina Schmidt and Ingo Schroder, 97-120. London: Routledge, 2001.

Schwandner-Sievers, Stephanie. "Jungfrauen und Elefanten im Porzellanladen: Zur internationaler Herausforderung der albanischen Ethnologie im Postsozialismus." In *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung*, edited by Oliver-Jens Schmitt, 187-214. München: Oldenbourg, 2009.